LIGJ
Nr.10 278, datë 13.5.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8246, DATË 1.10.1997 "PËR INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e Integrimit të të Përndjekurve", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1

Instituti i Integrimit të të Përndjekurve (IIP), si institucion shtetëror, në varësi të Ministrit të Drejtësisë, ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish-të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga Ministri i Drejtësisë.".

b) Në paragrafin e dytë, emërtimi "Këshilli i Ministrave" zëvendësohet me emërtimin "Ministri i Drejtësisë".

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP-ja mbështetet në një fond buxhetor, i cili miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.".

b) Në paragrafin e katërt, fjalët "raporton në Këshillin e Ministrave" zëvendësohen me fjalët "i raporton Ministrit të Drejtësisë".

Neni 4
Dispozita kalimtare

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 "Për Institutin e

Integrimit të të Përndjekurve”, mbeten në fuqi deri në daljen e akteve nënligjore përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

Fondi buxhetor, i miratuar për IIP-në, për vitin 2010, mbetet sipas strukturës buxhetore ekzistuese.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6578, datë 25.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi